



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 8 Dt. 13.02.2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “BLERIMI KOSTUR” SH.P.K

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”,(i ndryshuar), për paisjen me autorizim të subjektit **BLERIMI KOSTUR shpk**,me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore , Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**BLERIMI KOSTUR**”, me administrator **Z.Hasan MESHI**, për përdorim të burimit ujor **Lumi i Krumës** për prodhim energjie elektrike. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC RADA** do të ketë këto të dhëna: Vendndodhja: Fshati Mazrek, Krumë, Qarku Kukës.

Vepra e marrjes do të ketë koordinatat: X – 44 50 933; Y –46 73 739; Z – +400 m;

Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 46 723; Y –46 72 757; Z - +300 m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X - 44 46 723; Y –46 72 757; Z – +300 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 1.1 m³/sek.

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 1.6 m³/sek

Prurja ekologjike: Q_{ekol}= 0.12 m³/sek

Prurja që shkarkohet: 1.6 m³/sek.

2-Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI



KRYETAR

Paulin RADOVANI

